

Projekte me fondet e huaja nga Bashkia Kukës

A. Bashkia Kukës si partner: (Financuar nga BE)

1. Projekti i nëntokës: “EMOunderground”

Programi: INTERREG V-B Adriatic-Ionian ADRION Programme 2014-2020

Koha e zbatimit: 01.01.2020 - 30.06.2022

Shuma e parashikuar për bashkinë Kukës: 150,135 Euro

Lider: Komuna Nardo, Italy

Statusi i projekti: I mbyllur

Projekti ka si qëllim të jap një kontribut në vlerësimin e pasurive dhe potencialeve të aseteve kulturore të cilat do të çojnë në një zhvillim të qëndrueshëm, të zgjuar dhe gjithëpërfshirës në të gjithë zonën ku shtrihet projekti.

Probleme: Nuk ka hapësirë të përshtatshme për pajisjet ku mund të shikohet video virtuale e tuneleve, për shkak të lagështirës. Pajisjet janë të dhomat e poshtme të muzeu etnografik.

2. "Ujë i pastër në Kukës dhe Gjakovë"

Programi: IPA CBC Programme Albania-Kosovo

Koha e zbatimit: Janar 2020 – Dhjetor 2022

Shuma e parashikuar për Bashkinë Kukës: 466.000 Euro

Lider: NGO SHE-ERA, Gjakovë

Statusi i projekti: I mbyllur

Projekti ka si qëllim të përmirësojë politikat dhe praktikat e mbrojtjes dhe menaxhimit të ujit përmes përmirësimit të zbatimit të standardeve të ujërave të zeza. Investimi në Kukës përfshin ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza. Tashmë është kontraktuar kompania që do të merret me punimet dhe ka filluar puna.

Produkt: Kolektori i ujërave të zeza

B. Bashkia Kukës si lider (Financuar nga BE)

3. Mundësi të reja Kukës – NOK

Programi: EU for socio-economic development (as alternative to drugs cultivation and trafficking)

Koha e zbatimit: 1.09.2021- 1.09.2023

Shuma totale: 312.088 EUR (296,483 euro financimi i BE)

Partner: Europartners Development

Statusi: Në vazhdim (deri në fund të dhjetorit)

Me anë të këtij projekti do të mundësohet rritja e mundësive të punësimit për të rinjtë, për shkak së do të ofrohen kurse profesionale, duke i mbajt të rinjtë larg kultivimit të kanabisit.

Produktet kryesore:

1. Rehabilitim i qendrës NOK (dega ushtarake)
2. Kurse profesionale për të rinjtë (fillojnë me datë 23 Tetor)
3. 5 grante me nga 5000 euro për biznese të vogla (janë shpallë fituesit dhe pritet lidhja e kontratës)

4. ECO-ROUTES

Programi: IPA CBC Albania-Kosovo (Programi ndërkufitar Shqipëri Kosovë)

Shuma totale: 470.482 EURO (399.910 EURO financimi i BE)

Shuma për Bashkinë Kukës: 121,914.50

Partnerë: Komunën e Rahovecit dhe dy organizata (Urban Research Institute dhe Green Art Centre).

Koha e zbatimit: 24 Muaj (Nuk ka filluar akoma zbatimi për shkak se nuk kanë kaluar fondet.

Statusi: Në vazhdim (deri në muajin Mars 2023)

Ka si qëllim të kontribuojë në promovimin e rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm dhe atraktivitetit të zonave Kukës – Rahovecit në mënyrë që të shfrytëzohen më mirë potencialet e tyre turistike dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërkufitar duke promovuar rrugët e eko-turizmit në të dyja zonat si korridore natyrore dhe kulturore. Ndërhyrja në pjesën e Kukësit përfshin Shishtavec.

Produktet kryesore:

1. Video promociionale
2. Mure ngjitës më shkallë vështirësie të lartë dhe shtëpizë e vogël.
3. Kurse anglisht për të rinjtë që merren në fushën e turizmit
4. Aplikacion për orientimin e turistëve në shtigjet turistike
5. Shenjim shtigjesh dhe vendosje e tabelave orientuese
6. Organizim i aktiviteteve lokale (festa e Gjallicës)

Probleme: Fatura të papaguara

5. Programi ReLOaD - Financuar nga BE, zbatuar nga UNDP

Skema e granteve: Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2),

Periudha e zbatimit: 2021-2023

Shuma e projektit: 100 000 \$

Roli i Bashkisë: Bashkë-financues

Objektiv: Projekti do të punojë për të fuqizuar shoqërinë civile dhe rininë, për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje dhe për të promovuar një mjedis ligjor dhe financiar në funksion të shoqërisë civile.

Aktualisht, janë mbyllë 2 thirrjet e para dhe janë mbyllë aplikimet për thirrjen e 3-të. Shuma maksimale e aplikimit: 25.000 dollar.

C. Projekte nga donatorë të tjerë:

1. Ngritja dhe funksionimi i strehësës së emergjencës për gratë dhe vajzat e dhunuara – Thirrje nga **Ministria e Shëndetësisë**.

Ky projekt propozimi u hartuar në përputhje me qëllimin e Fondi Social për shërbime me bazë komunitare: Kontribuimi drejtpërsëdrejti në ofrimin e shportës së shërbimeve të kujdesit social për kategoritë në nevojë në nivel lokal, të përcaktuara në VKM 518/2018, përmes zbatimit të ngritjes së shërbimeve të reja ose përmirësimit të shërbimeve ekzistuese, si pjesë e planeve sociale të bashkive.

Statusi: I përfunduar

2. Projekti “Integration of children in the process of education and development in a pleasant environment”

Donator: Ambasada Bullgare

Shuma totale: 99.875 EURO (91.475 Euro financimi i Ambasadës)

Koha e zbatimit: 8 Muaj (1.04.2022-30.11.2022)

Statusi: I përfunduar

Projekti kishte si objektiv të përgjithshëm: Krijimin e një ambienti të këndshëm dhe të shëndetshëm për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor si brenda dhe jashtë kopshtit.

Produkt:

1. Rikonstruksioni i kopshtit nr 2, të lagjes numër 3 të Bashkisë Kukës.
2. Mobilimi me krevate, dyshek, televizorë, mjete didaktike
3. Rehabilitim i oborrit

3. Projekti “Parku i Aventurave në Shishtavec”

Programi: Skemës së Granteve të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit të Programit (PZHRSB).

Shuma totale: 18 040 636 lekë (14.996.363 financim i programit)

Koha e zbatimit: 29.01.2022-29.11.2022

Roli i Bashkisë: Lider

Statusi: I përfunduar

Kishte si qëllim të kontribuoj në rritjen e potencialit ekonomik në zonën e Shishtavecit, përmes promovimit të zonës nëpërmjet krijimit të hapësirave për zhvillimin e turizmit të aventurës dhe sporteve

4. Jo vetëm sport por dhe argëtim

Programi: Save the Children

Koha e zbatimit: 3 Muaj

Shuma totale: 1,363,048 ALL (930,439 ALL financimi nga programi)

Roli i Bashkisë: Lider

Statusi: I përfunduar

Objektivi: Ulja e ekspozimit ndaj faktorëve negativ të rrezikut shëndetësor tek të rinjtë nëpërmjet krijimit të ambienteve rekreative dhe sportive.

Produkt: Fusha e volejbollit në shkollën “Lidhja Prizrenit”

Aplikime në pritje

1. “As “NE” të mos mbetemi pas”

Programi: Askush te mos mbetet pas

Donator: UNDP

Shuma e kërkuar: 2,244,944 Lek

Statusi: i fituar

Produkt: Rehabilitimi i sallës së moshave të treta.

2. “Culture for Future”

Programi: IADSA (Italian – Albanian Debt for Development SĚAP Agreement (Second Phase).

Shuma e kërkuar: 57.194.105,00 Lek

Statusi: Në pritje

Produkt: Projekti përfshin rehabilitimin e sallës së madhe të pallatit të kulturës.

3. Ruajtja e kulturës, detyrë e brezave”

Donator: Ambasada Bullgare

Shuma e kërkuar: 129.000 euro

Statusi: Në pritje

Produkt: Rikonstruksioni i Muzeut Etnografik

4. Ruajtja e kulturës përtej kufijve

Programi: Binjakëzimi i qyteteve

Shuma e kërkuar: 25.000 Euro

Statusi: Në pritje

Produkt: Shkëmbim kulturor me të rinj nga Lituania